

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Politikat kontabel

1. Kuadri ligjor: Ligji 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
2. Kuadri kontabel i aplikuar: Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.
3. Baza e pergatitjes se PF: Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.
4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e PF

Njesia ekonomike raportuese ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.

Vijemisia e veprimtarise ekonomike te njesise sane raportuese eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.

Kompesimi midis nje aktivi dhe pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet ku lejohen nga SKK.

Kuptuesmeria e pasqyrave financiare eshte e realizuar ne masen e plate per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme te mjaftueshme ne fushen e kontabiliteti.

Materialiteti eshte vlersuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat financiare jane hartuar vetem per zera material.

Besuesmeria per hartimin e pasqyrave financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhtme :

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perpareshise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te tepruar , pa nen e mbi vleresimin te qellimshem .
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF
- Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat Kontabel.

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda e koston mesatare. Vlersimi fillestar i nje elementi aktiv afatgjate material qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vlersuar me kosto.

Per prodhimin ose krjimin AAM kur kjo financohet nga nje hua, koston e huamarrjes eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivitetit per periudhen e investimit.

Per vlersimin e mepasshem iAAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar .

Per llogaritjen e amortizimit te AAM njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit ate mbi bazen e vleres se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njejta me ato te ligjit fiskal ne fuqi.

- Kompjutera e sisteme informacioni 25% te vleres se mbetur
- Te gjitha AAM te tjera me 20% te vleres se mbetur

Administratori